



REPUBLIKA E LIBRAZHDSË  
KRYETARI

Nr. 1911 prot

Librazhd më 01/04 /2025

**VENDIM**

Nr. 6, Datë 04/04 /2025

**“PËR PËRCAKTIMIN E VENDEVE PUBLIKE NË TERRITORIN E BASHKISË  
LIBRAZHD PËR AFISHIMIN NGA ANA E SUBJEKTEVE ZGJEDHORE TË  
MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE PËR FUSHATËN ZGJEDHORE TË  
ZGJEDHJEVE TË DATËS 11.05.2025”**

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nënin 79 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin e KQZ Nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, nënin 9 të Vendimit Nr.12, datë 30.12.2020 “Për miratimin e rregullave të veprimtarisë së Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve”, si dhe shkresën Nr. 2210 prot date 27.03.2025 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve :

**VENDOSA:**

1. Përcaktimin e kriterëve për përdorimin e materialeve propagandistike/edukuese dhe përcaktimin e listës së sendeve apo materialeve të lejuara për fushatë, në zbatim të Udhëzimit nr.6 Datë 23.03.2021 "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore".
2. Vendet e caktuara për afishim në qytetin Librazhd janë: Sheshi “Gjorg Golemi”, Rruga Arberia, Qendrat e Njësisë Administrative, tabelat e reklamave në hyrje dalje të qytetit.

3. Hapësirat për secilën parti politike dhe subjekt zgjedhor, duhet të jenë sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor.
4. Caktimin e sheshit "Gjorg Golemi" si vend për afishimin e materialeve edukuese zgjedhore dhe informuese në dispozicion të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar.
5. Përdorimi dhe afishimi i çdo materiali statik për propagandë zgjedhore, përfshirë flamujt dhe posterat, lejohen vetëm në largësi deri 5 m nga zyra zgjedhore e partisë apo subjektit zgjedhor përkatës.
6. Ndalohet afishimi i materialeve në fasadat e godinave të banimit, institucionet publike apo ambjentet rrethuese pranë tyre, brenda zonave rekreative, parqeve në pemët e qytetit dhe shtyllat e ndriçimit.
7. Një kopje e këtij vendimi i komunikohet subjekteve zgjedhore.
8. Me marrjen dijeni të këtij vendimi subjektet zgjedhore brenda 5 ditëve kanë detyrim të japin informacion për adresat e sakta të zyrave elektorale dhe të bëhet verifikimi i tyre.
9. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Policia Bashkiake.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BASHKISË**  
**MARIGLEN DISHA**

